

VENDIM PËR MOSPRANIMIN
PËR SHQYRTIM TË
KËRKESËS ANKIMORE NR.
37, DATË 21.03.2023 TË
DEPOZITUAR NGA “PARTIA
DEMOKRATIKE E
SHQIPËRISË”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.01.2023

Nr: 32

Ora: 14:00

VENDIM

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 37, DATË 21.03.2023 TË
DEPOZITUAR NGA "PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 21.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Indrit Sefa;

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit 'Bashkë Fitojmë' (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Data: 21.03.2023 Nr: 32
Ora: 14:00



"Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga 'Partia Demokratike e Shqipërisë'"

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja "b", 123/1, 124, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Koalicioni Zgjedhor "BASHKË FITOJMË", ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023. Bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, pranë KQZ-së janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore partitë politike si më poshtë:
 - "Partia e Lirisë" me kryetar z. Ilir Metaj, miratuar me vendimin, nr. 154, datë 9.3.2023;
 - "Partia Demokristiane e Shqipërisë" me kryetar z. Nard Ndoka, miratuar me vendimin, nr. 111, datë 8.3.2023;
 - "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut" me kryetar z. Vangjel Dule, miratuar me vendimin nr. 135 datë 8.3.2023;
 - "Partia Demokratike e Shqipërisë" me kryetar z. Sali Berisha nuk është e regjistruar si subjekt zgjedhor;
3. Me shkresën nr. 1694 prot., datë 15.3.2023, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese "Partia e Lirisë", kërkojnë regjistrimin e koalicionit "Bashkë Fitojmë" (PL-PD-PDK-PBDNJ), si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit "BASHKË FITOJMË" (PL-PD-PDK-PBDNJ), është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni. Marrëveshja përmban:
 - Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
 - Formimin e koalicionit me emrin "Bashkë Fitojmë" (PL-PD-PDK-PBDNJ);
 - Shkronjat nistore të koalicionit "BF";



- Siglën e koalicionit;
 - Autorizimin e z. Ilir Metaj, kryetar i partisë “Partia e Lirisë”/ ose të autorizuarin prej tij, të dorëzojë listat shumemërore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit;
 - Fushata e koalicionit “Bashkë Fitojmë” do të drejtohet nga “Partia e Lirisë”;
 - Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
 - Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
 - Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ;
 - Numri i kandidatëve dhe renditja e tyre do të do bëhet sipas marrëveshjes midis palëve.
4. KSHZ me vendimin object ankimi ka konstatuar se kërkesa për t’u regjistruar si koalicion, është e bazuar për tre nga partitë pjesë e koalicionit konkretisht: “Partia e Lirisë” me kryetar z. Ilir Metaj, “Partia Demokratike e Shqipërisë” me kryetar z. Nard Ndoka, dhe “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” me kryetar z. Vangjel Dule.
5. Në seancën publike të zhvilluar në datën 18.3.2023, përfaqësuesi i autorizuar i Partisë së Lirisë, kërkoi regjistrimin si subjekt zgjedhor të koalicionit “Bashkë Fitojmë” BF. Përfaqësuesi i “Partisë Demokratike”, z. Sefa parashtroi se kërkesa është në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi përdorimi i emrit të Partisë Demokratike nga një subjekt tjetër përbën shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 66 të tij. Partia Demokratike, nuk është pjesë e asnjë koalicioni zgjedhor në këto zgjedhje dhe nuk ka asnjë vullnet për të hyrë në koalicion.
6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, I ka çmuar të drejta pretendimet e përfaqësuesit z. Sefa, se kërkesa e paraqitur nga Partia e Lirisë cënon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”. Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar z. Sali Berisha

nuk përmbush kushtet e nenit 65, pika 1 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk rezulton të jetë e regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, e si e tillë nuk mund të jetë pjesë e këtij Koalicioni.

7. Në këto kushte, KSHZ me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023 ka vendosur regjistrimin e Koalicionit "Bashkë Fitojmë" (PL-PDK-PBDNJ), "BF", si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, vetëm me partitë pjesëtare "Partia e Lirisë" (PL); "Partia Demokratike e Shqipërisë" (PDK) dhe "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut" (PBDNJ).
8. Kundër këtij vendimi të KSHZ ka paraqitur ankim Partia Demokratike, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa. Kjo kërkesë ankimore është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr. 37, datë 21.3.2023, në respektim të kriterëve të përcaktuara.
9. KAS-i caktoi me short z. Elvis Çefa si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës përgatitore në datën 21.03.2023, ora 13:30. Në seancë janë të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankuese, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa të cilët ishin njoftuar rregullisht për zhvillimin e seancës.

KAS-i konstaton:

1. E drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme.
2. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, KAS çmoi së pari të marrë në shqyrtim çështjen e legjitimitetit aktiv. Që kërkesa ankimore të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore:
 - a) interesi i ligjshëm;
 - b) legjitimiteti për të vepruar.

Interesi i ligjshëm, sipas arsytimit të vendimit nr. 12, datë 24.06.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye,

Data: 21.03.2023 Nr: 32
Ora: 14:00



"Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga "Partia Demokratike e Shqipërisë"

në esencë presupozon njohjen e cënimit të një interesi. Interesi i ligjshëm i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të cënuar.

3. Kodi Zgjedhor në nenin 130, shkronja "b" parashikon se KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (...) legjitimitimin e ankuesit. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës ankuese e cila ngre një pretendim, dhe që kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi.
4. Në momentin e regjistrimit pranë KQZ-së, çdo subjekt zgjedhor e kryen këtë veprim me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cilët subjekte të tjerë do të marrin pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm të paraqiste ankim, kundrejt vendimit të KQZ, për regjistrimin ose jo të vetë subjektit.
5. Në rastin konkret ankimesi, si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga KQZ si i tillë dhe për rrjedhojë nuk i është cënuar asnjë interes i tij. Regjistrimi nga KQZ i çdo subjekti tjetër apo mosregjistrimi i tij nuk cënon interesat e subjektit ankimes. Subjektet zgjedhore përfshirë partitë politike dhe koalicionet, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet e tjera që do të regjistrohen nga KQZ.
6. Vullneti që subjekti zgjedhor shpreh duke u rregjistruar, lidhet me interesin e tij të ligjshëm për të marrë pjesë në zgjedhje. Kërkesa për mos regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interes të ligjshëm të subjektit zgjedhor. Marrja apo mosmarrja pjesë në zgjedhje e çdo partie politike, apo bashkimi të subjekteve në formën e koalicioneve zgjedhore, nuk cënon interesat e ligjshme të ankimesit si subjekt zgjedhor i rregjistruar.
(Shih vendimin nr. 1, datë 09.05.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor)
7. Vlen të theksohet se është standart dhe praktikë zgjedhore që disa subjekte politike kanë përfaqësim të akredituar në KQZ dhe marrin pjesë në procesin administrativ të vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për aktet kryesore të procesit, sikundër është regjistrimi i subjekteve zgjedhore. Po ashtu vlen të evidentohet në rastin



konkret, se subjekti zgjedhor Partia Demokratike (PD) ka ngritur një pretendim për mos regjistrimin si subjekt zgjedhor pjesë e koalicionit "Bashkë Fitojmë", të subjektit PD (me kryetar z. Sali Berisha) që në fazën fillestare të paraqitje të kërkesës para Komisionerit.

8. Komisioneri me vendimmarrjen e tij ka regjistruar vetëm koalicionin e përbërë nga PL-PDK-PBDNJ. Në këtë moment pretendimi i ngritur nga PD në KAS, konsiderohet i zgjidhur duke mos pasur më ky subjekt (PD) asnjë "interes të ligjshëm" në kuptim të Kodit Zgjedhor, kundrejt regjistrimit të koalicionit "Bashkë Fitojmë", i cili tashmë përbëhet nga tre subjektet zgjedhore, PL, PDK dhe PBDNJ të cilat kanë identitet të qartë dhe të ndryshëm politik nga ankuesi PDSH. Pavarësisht nga marrëveshjet që këto subjekte kanë me njëra-tjetrën apo me grupime të ndryshme që kanë ose jo cilësitë e një subjekti politik, për efekt të kësaj gare zgjedhore, në fletën e votimit që do të kenë zgjedhësit në qendrën e votimit, do të pasqyrohet subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë" me shkronjat nistore "BF", me partitë përbërëse PL-PDK-PBDNJ. Pra vendimmarrja e KSHZ, qartësisht i ka dhënë zgjidhje edhe këtij kërkimi të subjektit Partia Demokratike.
9. Duke qenë se objekt kundërshtimi është vendimi nr. 178, datë 18.03.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit "Bashkë Fitojmë" (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", subjekti ankues do të duhej të provonte ekzistencën e interesit të tij që cenohet nga vendimi të cilin ai kundërshton. Nga spjegimet e përfaqësuesit të subjektit ankimues në seancën paraprake përpara KAS, rezultoi se PD në fakt nuk kundërshton në vetvete regjistrimin e koalicionit zgjedhor "Bashkë Fitojmë" (i cili udhëhiqet nga Partia e Lirisë në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor), por kundërshton "Deklaratën e Koalicionit" e paraqitur nga partitë përbërëse të këtij koalicioni dhe kjo për shkak se në këtë deklaratë përmendet emri i PDSH si pjesëmarrëse në koalicion. Përfaqësuesi i ankimuesit pranoi faktin se në vendimin objekt ankimi, KSHZ pikërisht sipas kërkesës së vetë partisë ankimuese, nuk e ka përfshirë emrin e PDSH si parti formuese e koalicionit zgjedhor "Bashkë Fitojmë". Në këtë kontekst, edhe nëse KAS eventualisht do të vendoste të pranonte kërkesën e ankimuesit, sërish do të ishte i pakuptimtë shfuqizimi i vendimit nr. 178, datë 18.03.2023, sepse edhe në vendimmarrjen pasuese të Komisionerit



në raport me koalicionin "Bashkë Fitojmë" do të kishte të njëjtën vendimmarrje. Në këtë kontekst, kërkesa ankimore në fakt është pa objekt.

10. Pjesëmarrja e subjektit PD në fazën e shqyrtimit të regjistrimit të koalicionit nga KSHZ nuk mund të shërbejë si shkak legjitimimi "automatik", për efekt të ankimit në KAS, si dhe në të njëjtën analogji përpara Kolegjit Zgjedhor. Në cdo rast do duhet që të vlerësohet, nëse ka apo jo interes të ligjshëm të ankuesit pavarësisht qënies si palë në shqyrtimin administrativ.
11. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me Vendimin nr. 12, datë 24.06.2019, midis të tjerash përcakton se *"... sa i takon legjitimitet të paditësit, vlerësoj të theksoj se për të parashtruar përpara gjykatës një kërkim të caktuar është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobija personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme..."* (Vendimi nr. 91, date 19.03.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).
12. Po ashtu ky qëndrim është mbajtur edhe më përpara nga KAS, referuar vendimmarrjes së mëparshme të tij, konkretisht vendimit nr. 06, datë 07.02.2021, "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 02, datë 05.02.2022 të Partisë Demokratike". Edhe rasti konkret është pothuajse identic me rastin e trajtuar në vendimmarrjen e mësipërme dhe në këto kushte nuk ka asnjë arsye për ndryshimin e kësaj praktike tashmë të konsoliduar.
13. Përfundimisht, në vlerësimin e anëtarëve në shumicë të KAS, ankimuesit nuk i është shkelur ndonjë e drejtë dhe as cënuar interesi i ligjshëm i pretenduar. Për pasojë ai nuk legjitimohet në kundërshtimin e vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të KSHZ-së. Regjistrimi i koalicionit "Bashkë Fitojmë" (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk ndryshon apo cënon kushtet e konkurrimit për asnjë nga subjektet e tjera zgjedhore.



PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja "b", dhe 129, pika 3, shkronja "b" të Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, neni 17, pika 3, shkronja "b" dhe neni 18, pika 1, shkronja "a", të vendimit nr. 3, datë 6.11.2020 të Komisionit Rregullator, Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023, të paraqitur nga "Partia Demokratike e Shqipërisë",
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar (Kundër)
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Kundër)



MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt *“Shfuqizimin e vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”* (në vijim vendimi nr. 178, datë 18.03.2023) shprehemi kundër vendimit të shumicës për moskalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore.
2. Shumica e anëtarëve të KAS-it ka çmuar se ankuesit i mungon legjitimiteti për të vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) me kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr. 178, datë 18.03.2023. Ne, anëtarët në pakicë, e gjejmë vendimin e shumicës të pambështetur ligj si në arsyetimin ligjor, ashtu dhe në konkluzione, inkoherent me praktikën e KAS-it dhe të padrejtë. Në vlerësimin tonë, legjitimiteti i ankuesit në çështjen objekt shqyrtimi është i padiskutueshëm dhe KAS-i duhet të kishte pranuar për shqyrtim kërkesën ankimore nr. 37.
3. Vlerësimi nëse një subjekt zgjedhor (neni 124, pika 1 e K. Zgjedhor) apo një palë e tretë (neni 124/1, pika 2 e K. Zgjedhor) ka ose jo mjaftueshëm interes të ligjshëm, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Subjekti zgjedhor ose pala e tretë që vë në lëvizje KAS duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe aktit administrativ që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për paligjshmërinë e aktit administrativ që ka sjellë këtë cënim të interesit. Vetëm fakti se akti administrativ i kundërshtuar mund të ketë ose ka pasur një efekt çfarëdo për ankimuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e ankimit, por është e nevojshme të provohet se akti administrativ i kundërshtuar cënon interesat e ankimuesit, sipas përcaktimeve të bëra në K. Zgjedhor.
4. Për rastin në shqyrtim, ankuesi ka parashtruar para KAS-it argumente në lidhje me cënimin e interesave që vendimi nr. 178, datë 18.03.2023 passjell për subjektin zgjedhor Partia



Demokratike e Shqipërisë. Sipas tij, pretendimet e ankuesit "janë marrë vetëm pjesërisht në nga KSHZ, vetëm për pjesën në të cilën ky i fundit ka refuzuar të përfshijë si pjesëmarrës në koalicionin subjektin e pretenduar Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga shtetasi Sali Berisha në cilësinë e pretenduar të kryetarit të kësaj partie". Po kështu, ankuesi ka parashtruar pretendimin se Komisioneri nuk ka urdhëruar korrigjimin e dokumentacionit shoqërues të kërkesës për regjistrimin e koalicionit "Bashkë Fitojmë", duke lejuar që "në aktet e depozituara në KQZ të vijojë të rezultojë si pjesë e kërkesës, pjesë e marrëveshjes dhe për pasojë edhe pjesë e pretenduar e koalicionit subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë në koalicionin "Bashkë Fitojmë". Këto janë shqetësime që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen në shqyrtim dhe formojnë interes të ligjshëm për ankuesin, sepse kanë lidhje të drejtpërdrejtë me identitetin e tij politik. Këto shqetësime meritojnë shqyrtim procesual dhe vendimmarrje institucionale. Vendimi i shumicës së KAS e bllokoi këtë rrugë, prandaj është i padrejtë.

5. Vendimmarrja e shumicës së anëtarëve të KAS-it është mbështetur mbi një "precedent" të kundërshtuar atëkohë në të njëjtën mënyrë nga anëtarë në pakicë. Bëhet fjalë për vendimin e KAS-it nr.06, datë 07.02.2022 "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 2, datë 05.02.2022 të Partisë Demokratike". Duke refuzuar shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 2, datë 05.02.2022 të Partisë Demokratike, KAS-i pengoi shqyrtimin e pretendimit të ankuesit për korrigjimin e akteve bashkëshoqëruese, specifikisht të marrëveshjes së koalicionit të atëhershëm "Shtëpia e Lirisë". Pasoja ishte përfshirja në zgjedhje e subjektit "Partia Demokratike - Komisioni i Rithemelimit", pavarësisht se Komisioneri i kishte hequr formalisht të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje, lejimi i një fushate agresive publike dhe mediatike nga ana e këtij subjekti të ndaluar, në dëm të interesave të subjektit të regjistruar dhe të ligjshëm "Partia Demokratike", çoroditja e elektoratit nga qëndrimi i dyzuar dhe kontradiktor i KQZ-së në raport me subjektin e ndaluar, si dhe dështimi i KQZ-së për të nxjerrë "jashtë ligjit" dhe për të ndëshkuar praktikën çoroditëse të fushatës agresive nga një subjekt i ndaluar, duke uzurpuar identitetin e një subjekti legjitim dhe të regjistruar në garën elektorale të 6 marsit 2022.
6. Precedenti i mësipërm i KAS-it, i gabuar në gjykimin e anëtarëve në pakicë, rrezikon të përsërisë të njëjtën shfaqje kundërligjshmërie dhe të demonstrojë të njëjtën shkallë pasiviteti fajtor nga ana e KQZ-së, sikurse ndodhi në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022, në rast se KAS-i do



t'i shmanget, nëpërmjet moslegjitimit, edhe këtë herë përgjegjësisë për të marrë në shqyrtim dhe zgjidhur pretendimet e ankuesit.

7. Vendimi i Komisionerit nr. 178, datë 18.03.2023 është marrë në procedurë administrative, në të cilën përfaqësuesi i ankuesit ka marrë pjesë aktivisht. Përfaqësuesi i ankuesit ka ndërhyrë në proces me vërejtje dhe pretendime rreth objektit të çështjes në shqyrtim. Komisioneri i është referuar në arsyetimin e vendimit prapësimeve procedurale të paraqitura nga përfaqësuesi i ankuesit, kur ka vlerësuar se i gjen *"të drejta pretendimet e përfaqësuesit z. Sefa, se kërkesa e paraqitur nga Partia e Lirisë cënon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor "Partia Demokratike" pasi sipas kësaj kërkesë kërkohet që të bëhet regjistrimi i një koalicioni zgjedhor me përbërjen "Partia e Lirisë", "Partia Demokratike e Shqipërisë", "Partia Demokratike e Shqipërisë", "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut". Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar z. Sali Berisha nuk përmbush kushtet e nenit 65, pika 1 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk rezulton të jetë e regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, e si e tillë nuk mund të jetë pjesë e këtij Koalicioni"*.
8. Vendimi nr.178, datë 18.03.2023 është provë e faktit se subjekti zgjedhor Partia Demokratike është legjitimuar si palë në procedurën administrative të shqyrtimit të një kërkesë për regjistrim të një subjekti tjetër zgjedhor si koalicion, pavarësisht se ajo nuk ishte pjesë e këtij koalicioni. Komisioneri ka njohur interesin legjitim të subjektit "Partia Demokratike e Shqipërisë" në procedurën për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit zgjedhor "Bashkë Fitojmë". Interesi legjitim në një procedurë administrative përfshin detyrimisht edhe të drejtën e palës për të kundërshtuar rezultatin e procedurës administrative, që në rastin konkret është vendimi nr. 178, datë 18.03.2023.
9. Fakti që vendimi nr. 178, datë 18.03.2023 ka pranuar kërkesën e përfaqësuesit të ankuesit dhe ka modifikuar përbërjen e koalicionit, duke fshirë nga koalicioni emrin e subjektit "Partia Demokratike" nuk mund të lexohet, sikurse bën shumica në KAS, se interesi i ligjshëm është përmbushur me këtë akt dhe se ankuesi ka marrë atë që kërkonte.
10. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë që pretendimet e veta t'i nënshtrohen shqyrtimit administrativ nga instanca ankimore, ka të drejtë të pretendojë se kërkesat e tij nuk janë pranuar plotësisht,



ose se pranimi i bërë, nuk i ka mbrojtur sa duhet ose ka lejuar cënimin e interesave të ligjshme në një ose disa drejtime të tjera. Vendimi i shumicës në KAS ia ka mohuar ankuesit mbrojtjen e këtyre të drejtave e pretendimeve.

11. Në lidhje me jurisprudencën zgjedhore sa i përket ankimimeve nga një subjekt zgjedhor ndaj veprimtarisë së një subjekti zgjedhor në formën e një koalicioni pjesë e të cilit ai nuk është, i referohemi edhe vendimit nr. 9, datë 23.03.2021 të vetë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ku ka legjitimuar subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë në ankimin e saj ndaj një vendimmarrjeje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për listën e kandidatëve të subjektit zgjedhor koalicionit PD-AN. Ky qëndrim (në lidhje me interesin e ligjshëm) u konfirmua dhe nga Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 3, datë 29.03.2021 të tij. Madje, Kolegji Zgjedhor, duke argumentuar se *"... nevojat e secilit subjekt zgjedhor, kur merr pjesë në garë plotësohen në përputhje me ligjin zgjedhor, i cili gjen njësoj zbatim edhe prej subjekteve të tjera zgjedhore"* i ka bërë një interpretim të zgjeruar interesit të ligjshëm të subjekteve zgjedhore në zgjedhje.
12. Prandaj, ne anëtarët në pakicë të KAS, bazuar edhe në jurisprudencën e këtij komisioni si dhe të Kolegjit Zgjedhor, për legjitimitimin e ankimuesit, arrijmë në përfundimin se edhe në çështjen konkrete ankimuesi ka arritur të provojë interesin e tij për ta vënë në lëvizje KAS-in, prandaj legjitimohet *ratione personae* për të iniciuar kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të KSHZ objekt shqyrtimi.

Ledio BRAHO - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Data: 21.03.2023 Nr: 32
Ora: 14:00



"Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga 'Partia Demokratike e Shqipërisë'"

Revision #2

Created 2023-03-30 11:55:59 UTC by P. P

Updated 2023-03-30 11:58:20 UTC by P. P